



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 11 Datë 25.02.2022

Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të pasurisë nr 663 (pjesë), Zk nr 2708, për antenë celulare, në fshatin Mnelë e Vogël, subjektit “ALBtelecom” Sha.

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, neni 9, pika 1.2, ligji nr 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. “, Në VKM nr 10, dt 07.01.2005, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Vig Mnelë”, në VKM nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira , enfitoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit Nr 03. Datë 31.01.2022, paraqitur nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit, Sektori i Aseteve, ku propozohet “Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të pasurisë nr 663 (pjesë), Zk nr 2708, për antenë celulare, në fshatin Mnelë e Vogël, subjektit “ALBtelecom” Sha.”. Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

1. Miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të pasurisë nr 663 (pjesë), Zk nr 2708, për antenë celulare, në fshatin Mnelë e Vogël, subjektit “ALBtelecom” Sha.”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”)

KRYETAR

Mark BISHA

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 03.03.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
Sektori i Aseteve

Nr 5114-Prot

Vau Dejës me 03.02-2022

RELACION

MBI RINOVIMIN E KONTRATES PËR DHËNIE NË PËRDORIM SUBJEKTIT
“ALBTELEKOM”, Sh.a, STACIONI NR **SH 1008 MNELE E VOGËL** PËR ANTENË TË
TELEFONISË CELULARE

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, është edhe dhënia në përdorim me apo pa konkurim e pronave të saj, të tretëve.

Kontrata nr 6675 prot, datë 22.11.2021,e lidhur mes Bashkisë Vau Dejës dhe Shoqërisë “**Albtelekom**” **sha.a**, ka përfunduar afatin e saj me datë 13.01.2022, bazuar në vullnetin dhe dakordësinë e palëve kërkohet rinovimi i kësaj kontrate për përdorimin e truallit në pasurinë nr 663, Zk 2708 ne fshatin Mnelë e vogël, stacioni **nr SH1008**. Kjo kontrate ka qenë e lidhur me afat 1 vjeçar, me **vlerë vjetore = 324 000 lekë**, llogaritur sipas VKM nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar..

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e rinovimit të kësaj kontrate, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi për shfrytëzimin e sipërfaqes së truallit të dhënë me qira, pjesë e pasurisë nr 663, Zk 2708, sipas kushteve dhe objektit të kontratës pararendese.

Duke ju falenderuar, ju ftojme të miratoni projekt vendimin.

Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: Ndoc Baqli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 2045946
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. SHKODËR Zona Kadastrale Nr. 2708
Numri i Pasurisë 663 Volumi 3 Faqe 163
Adresa e Pasurisë MNELE E VOGEL
Lloji i Pasurisë TRUALL
Sipërfaqja Totale 29180.00 m2
Nga kjo : Sa Truall 29,180.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 250.00
Nqs pallat: Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)				
Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BASHKIA	VAU DEJËS		1/1	VAU-DEJËS
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

- është pronar i _____ pasurisë me numër 663
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 28/4/2020 Nr. 5381

Data e lëshimit të çertifikatës
28/4/2020

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
ILIR DIBRA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 165/1 prot.

Shkodër, më 15.03.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 11, datë 25.02.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, dt. 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Kreu III, pika 11, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 10, shkronja "j", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, gërma a, neni 54, shkronja "e/l", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të VKM nr. 10, datë 07.01.2005 "Për miratimin e listës së pronave të palujtshme shtetërore, në Komunën Vig Mnelë", të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, neni 5, shkronja "a", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 1164 prot., datë 03.03.2022 "Dokumentacioni shoqëruar i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës të datës 25.02.2022", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 11, datë 25.02.2022 "Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të pasurisë nr. 663 (pjesë), ZK 2708, për antenë celulare në fshatin Mnelë e Vogel, subjektit Albtelekom sh.s.", sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. 2045946, datë 28.04.2020 të ZVRPP Shkodër, për pasurinë nr. 663, ZK 2708, me afat 1 vjeçar dhe vlerë vjetore prej 324.000 lekë.

Për sa më sipër, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
NË MUNGESË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

